

Në sallonin e ekspozitës është prezantuar bizhuteri i vjetër me shekuj që i ka mbledhur gjyshi i tij, por edhe vepra që vetë Vangel Dereban i ka përpunuar, që datojnë nga shekulli 18 dhe 19, të përpunuara nga argjendarët e Maqedonisë

Në shtëpinë e rinovuar në çarshinë e vjetër të Ohrit, "Te shkal-lët", ku dikur ishte punësoria e artistit të madh dhe të njohur të filigranit, mjeshtër Vangel Dereban, këtë ditë u hap një Muze kushtuar filigranit, vend ku do të prezantohet filigrani, ekspozita e relikeve të filigranit si dhe prezantimi i të gjithë thesarit kulturor të ruajtur nga familja e famshme e Ohrit, Derebanovi.

Objekti modest ka tre hapësira, njëra prej të cilave është e rezervuar për vendosje që ekspozon bizhuteri dhe objekte të bëra nga mjeshtër të filigranit, pastaj një pasqyrë historike të artizanatit të filigranit nëpër kalimin e kohës, si dhe një punëtori për mësimin, njohjen dhe prezantimin e aftësitë të filigranit.

"Muzeu si projekt është i mbështetur nga BE -ja dhe synon të prezantojë filigranin tek turistët, bashkatdhetarët dhe të gjithë individët dhe institucionet e tjera për të zbuluar se kush ishim dhe kush

## HAPET MUZEU PËR FILIGRAN DEDIKUAR VANGEL DEREBANIT



jemi ne maqedonasit. Gjyshi im Vangel na la një amanet për të vazhduar farkëtarinë, pavarësisht nga profesioni ynë i jetës", këtë e tha në hapjen e muzeut Nikolla, nipi i mjeshtër Vangel Dereban, i cili, ashtu si gjyshi dhe babai i tij, e njeh këtë zanat të rrallë dhe shumë të vlerësuar në vendin tonë dhe më gjerë.

Në sallonin e ekspozitës është prezantuar bizhuteri i vjetër me shekuj që i ka mbledhur gjyshi i tij, por edhe vepra që vetë Vangel Dereban i ka përpunuar, që datojnë nga shekulli 18 dhe 19, të përpunuara nga argjendarët e Maqedonisë. Ka bizhuteri si për gratë ashtu edhe për burrat, zbukurime koke, bizhuteri për rroba, mjete fe-

tare dhe kishtarë, deri tek mjetet e burrave nga filigrani, të tilla si mbajtëse, kibuci dhe të ngjashme. Në muze ka edhe hapësirë për punëtori në të cilën do të angazhohen disa mjeshtër nga Ohri për të bërë filigran, për të mësuar të rinjtë e interesuar për zanatin, por edhe për të prezantuar para turistëve se si bëhen objektet e filigranit, në mënyrë që të vazhdojnë zanatin e vjetër dhe të rrallë të argjendarit të famshëm të Ohrit dhe Maqedonisë Vangel Dereban, për të cilin njerëzit e Ohrit kujtojnë me kënaqësi. Në hapjen e muzeut me punëtorinë u prezantua edhe ribotimi i librit "Makedonski nakit" i Vangel Dereban.

Vangel Dereban lindi në vitin

1920 në Strugë, ndërsa vdiq në moshën 93 vjeçare. Që nga fëmijëria e tij e hershme ai ishte një çirak filigrani dhe është brezi i gjashtë i mjeshtërve të filigranit të familjes Derebanovi. Flutura e argjendit e njohur për spotin televiziv "Blini produkte të Maqedonisë", i cili ruhet në Muzeun Kombëtar të Maqedonisë, është punuar nga babai i tij Aleksandri. Për Vangel Dereban janë botuar tekste dhe raporte të shumta në revista vendase dhe të huaja nga publicistë të njohur, tekste përmes të cilave janë promovuar qyteti i Ohrit dhe Maqedonia. Vepra të shumta filigrani të bëra kryesisht prej argjendi me motive nga Ohri dhe Maqedonia të shumë shekujve më parë, Vangel Dereban ua ka kushtuar shumë njerëzve me famë botërore nga bota politike, kulturore, filmit, muzikës, mbretër, princa, të cilët vizituan dyqanin e tij të vjetër dhe të rrënuar, i vendosur atëherë në zemër të çarshisë së vjetër të Ohrit.

Mjeshtri i filigranit nga Ohri, Vangel Dereban është fitues i shumë shpërblimeve dhe mirënjohjeve, mes të cilave edhe Shpërblimi i Shën Klimentit i qytetit të Ohrit. (K. Spaseski)



## Çmimi "Naxhi Naaman" për Vasil Tocinovski

Çmimi Letrar Ndërkombëtar "Naxhi Naaman" është një mirënjohje e re për shkrimtarin dhe studiuesin maqedonas Vasil Tocinovski. Bëhet fjalë për mirënjohje që jepen në më shumë kategori dhe kanë traditën dhe vazhdimësinë e tyre për nëntëmbëdhjetë vjet. Ato u krijuan në vitin 2002 dhe "u ndahen autorëve të veprave letrare që janë më të emancipuar në përmbajtje dhe stil, dhe qëllimi i të cilëve është të ringjallin dhe zhvillojnë vlerat njerëzore". Juria shpalli fituesit në më shumë kategori dhe ata u përzgjedhën në një konkurs prej 3,217 pjesëmarrësish nga 80 vende që kanë shkruar, krijuar në 60 gjuhë.

Vasil Tocinovski është bartës i mirënjohjes për të gjithë veprën letrare dhe shkencore. Në shtator 2021, organizatori njoftoi, fituesit do të shohin tekste të tyre të zgjedhura të shtypura në librin vjetor në serinë letrare falas të Fondacionit për kulturë të lirë "Naxhi Naaman". Fituesit me të bëhen edhe anëtarë nderi të Shtëpisë së kulturës të Namaan në Beirut, Liban. Ajo që me siguri duhet të theksohet është fakti se bartësi i propozimit për një fitues të mundshëm të mirënjohjes për Tocinovskin është autorja e njohur poetike Olga Laliq Kroficka, poetë, eseiste, kritikuese, kolumniste dhe përkthyes. E saj është gjithashtu edhe zgjedhja nga vepra poetike e autorit maqedonas Tocinovski si një kontribut i veçantë me përkthime nga maqedonishtja në anglisht, gjermanisht, frëngjisht, polonisht, kroatisht dhe serbisht. Ky është një fakt befasues, sepse ai është një shkrimtar vargjet e të cilin janë botuar në disa revista polake, antologji, ndërsa në vitin 2015 u botua libri i tij me tregime të shkurtra "Nga anë tjetër e detit", i cili u pasua nga interpretime dhe vlerësime kritike të lavdërueshme. Puna krijuese e Vasil Tocinovskit është 91 libra trillues (poezi, tregime të shkurtra, romane për të rritur dhe fëmijë dhe të rinj, kritikë letrare dhe ese) dhe histori letrare maqedonase, ai është nënshkruar i 70 botimeve dhe përzgjedhjeve nga trashëgimia letrare maqedonase dhe botuese, ai ishte bashkëpunëtor në 22 enciklopedi, libra shkollorë, manuale dhe koleksione. Ai ka botuar rreth 2,000 studime letrare, kritika, ese dhe regjistrime brenda dhe jashtë vendit. Është përkthyer në njëzet gjuhë dhe ka fituar tridhjetë çmime dhe njohje të rëndësishme, prestigjioze vendase dhe të huaja. (T.V)

## PESËMBËDHJETË VJET NË SHËRBIMIN E BOLIDËVE

Metodija Taleski-Gjermani është pensionist në moshën 77-vjeçare. Ai lindi në fshatin Çumovë, afër Prilepit, u shpërngul dhe mësoi zanat nëpër shkollat dhe kompanitë e Prilepit dhe 55 vjet më parë u largua për në Gjermani. Prandaj banorët e Prilepit tani e quajnë Gjermani. Ai u kthye në Prilep me familjen e tij 12 vjet më parë dhe këtu i kalon ditët e pensionit. Ai rri nëpër bare, natyrisht në ambient të hapur dhe bisedon me bashkëqytetarët e tij për të tashmen, këtu dhe kohën kur ai ishte dhe punonte si trajner driblimi në Këln, Gjermani. Ndërsa, atje ai punoi në më shumë vende dhe në më shumë punë derisa aplikoi për konkursin për shërbim për përpunimin e pjesëve për makinat e Formula 1 dhe u pranua. Atje, Taleski me saktësi të madhe i ka rregulluar pjesët e dëmtuara të makinave, për çka është shpërblyer mirë. Në fabrikën si specialist në pjesët e makinave, ai gjithashtu ka përpunuar edhe pjesët për termocentralet bërthamore. Edhe pse ishte 45 vjeç kur u pranua "në shikim të parë" sepse ishte një mjeshtër i dëshmuar dhe me përvojë në kompaninë e mëparshme nga e cila ishte larguar.

"Për pesëmbëdhjetë vjet unë isha në gatishmëri edhe ditën edhe natën edhe gjatë festave. Nuk diheshte orari im i punës. Ftoheshja për të përpunuar pjesët e vogla të defekteve në përgatitjen e makinave Toyota për garat e Formula 1. Shpesh zgjoheshja në orët e hershme të mëngjesit dhe ose me taksë ose me makinën time isha menjëherë në fabrikë. Pjesa e makinës duhej të rregullohet dhe të dërgohet atje ku duhej të ishte, ku ishin makinat e garave. Pas vizatimeve të inxhinierëve, unë përgatisja pjesët e reja në kohën më të shkurtër për t'u

montuar në vendin e atyre të dëmtuarave dhe për të arritur në pistat e garave në të gjithë botën sa më shpejt që të ishte e mundur. Pjesët u nënshtroheshin një kontrolli të saktë dhe të detajuar para se të transportoheshin. Dhe, ja nuk është për t'u lavdëruar", thotë Taleski.

"Në përvojën time të punës kaq shumë vjeçare nuk ka ndodhur që të rregulloj një pjesë për herë të dytë. Akset, vidhat dhe elementët e tjerë të nevojshëm i kam bërë me lehtësi. Kur punoja në stacionin e shërbimit Toyota, ishte koha e Shumaherit. Ata më dërgonin vizatime dhe punoja sipas tyre. Unë e mbaja zanatin në gishtin tim të vogël. Ashtu siç thuhet çelikut ia njihja shpirtin. Disa pjesë i kam përpunuar përdërisa inxhinierët pinin kafe. Ishte pak e çuditshme për ta se si ishin bërë me precizion mikron, pa asnjë të metë. Nëse kishte një gabim, e shifsha menjëherë vetë dhe e rregullojsha. Më pyetshin se si i bëj të gjitha këto në një kohë kaq të shkurtër. U thosha, me duart e mia, se si ndryshe! Ata ishin shumë të drejtë me mua, sepse në një farë mënyre unë isha një mjeshtër i rëndësishëm për ta. Në driblim kam punuar më mirë sesa në makinat moderne CNC. Ato ishin për prodhim serik, jo për pjesë individuale", thotë Taleski. Ai mori një kurs në makinat CNC, por disa nuk i është përshtatur atij. Ai ishte mësuar të punonte në driblim që në rininë e tij kur zotëronte zanatin në DIK "Crn Bor" në Prilep.

Ai e dinte se si rrashte "zemra" e driblimit. Përveç studimit të zanatit, në shtëpi në Prilep, ai punoi në Bullgari dhe Kroaci nëpër anije. Ai u nis për në Gjermani në moshën 24 vjeç. Ai fitoi shumë praktikë. Ai i këshillon të rinjtë të punojnë atë që u përshtatet atyre, atë që ata



dinë dhe mund të bëjnë. Ai ende ka saktësinë e duarve të tij. Tani ai ecën shumë, shijon ditët e pensionit. Me kolegët e tij pensionistë, të cilët në Prilep e quajnë gjermani, ndërsa në Gjermani e kanë quajtur maqedonasi, ai ecën rregullisht në malet përreth. Ai ka një të kaluar me alpinistët dhe ka pushtuar shumë majat e maleve në Maqedoni, Bullgari, Serbi, Greqi ... I do malet dhe gjetinë. Ai është në gjakun e tij dhe në këtë aspekt ai ka vërtetuar saktësinë e tij. Ka kapur, kur lejohet, më shumë derra të egër dhe gjah të tjerë. "Ndihem mirë në shtëpi, me familjen dhe miqtë", thotë Metodija Taleski - gjermani, maqedonasi, gjegjësisht burri nga Prilepi. (K. Ristestki)